

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC

Nr. 01.400.52318

Më
On. 14.10.2021



KËSHILLI STUDENTOR
FAKULTETI JURIDIK

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të

**KËSHILLIT TË STUDENTËVE TË FAKULTETIT JURIDIK TË
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

dhe

KOMUNËS SË DRENASIT

PRISHTINË
Tetor 2021

Këshilli i Studentëve i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Komuna e Drenasit e Republikës së Kosovës. (referuar si Palë)

Bien dakord për nënshkrimin e këtij memorandumi bashkëpunimi me qëllim krijimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit, mundësisë për punë praktike të studentëve të këtij fakulteti e që do të mundësonte ndihmën reciproke, ngritjen e aftësive si dhe zhvillimin personal dhe profesional të studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët për ngritjen dhe zhvillimin personal dhe profesional të studentëve të Fakultetit Juridik.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit dhe ndihmën reciproke që mund të ofrohet nëpërmjet bashkëpunimit këto dy palë.

Duke vlerësuar rëndësinë e përvojës së krijuar nga puna praktike, e cila sot kërkohet në çdo institucion, pesha dhe ndikimi që ajo posedon në të ardhmen edhe në zhvillimin e shtetit.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e aftësimit dhe përgatitjes së juristëve të rinj edhe për profesionin që do të ushtrojnë.

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimeve të këtij memorandumi për të përmbushur dhe realizuar aktivitete të përbashkëta.


Palët janë të lidhur me këtë memorandum bashkëpunimi me përmbajtjen e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

Palët do të jenë pjesë e një bashkëpunimi me qëllim të:

- a) Ngritjes dhe zhvillimit personal dhe profesional të studentëve të Fakultetit Juridik nëpërmjet ofrimit të punës praktike;
- b) Perfeksionimit, praktikimit, respektivisht zbatimit të njohurive të marra gjatë studimeve;
- c) Ofrimin e mundësive të reja për studentët e Fakultetit Juridik, praktikimi dhe ofrimi i ndihmës për stafin esencial;
- d) Përfshirjes në aktivitete të përbashkëta dhe të veçanta;



Neni 2

Fusha e zbatimit

Me qëllim zbatimin me korrektësi të këtij memorandumit, Palët angazhohen:

- a) Të dërgojnë listën e studentëve të përzgjedhur për punë praktike;
- b) Të ofrojnë punë praktike me qëllim përmbushjen e qëllimeve të memorandumit;
- c) Të ofrojnë këtë punë praktike brenda periudhës së studimeve të vitit akademik.

Neni 3

Format të tjera bashkëpunimi

- a) Palët angazhohen të ofrojnë këshillime, asistencë, ofrimin e materialeve mbështetëse në përgjigje të arritjes së qëllimeve përkatëse të Memorandumit;
- b) Palët angazhohen të llobojnë në favor të njëra-tjetrës për çështje të interesit të përbashkët apo respektiv.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komunës së Drenasit

- a) Pala do të ofrojë mundësi për punë praktike për studentët e Fakultetit Juridik brenda këtij institucioni;
- b) Të ofrojë mbështetje dhe të angazhoj stafin esencial t'iu ofroj ndihmë praktikantëve të dërguar nga Këshilli i Studentëve i Fakultetit Juridik me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të tyre personal dhe profesional;
- c) Të jep mbështetje dhe të bashkëpunoj me Këshillin e Studentëve të Fakultetin Juridik gjatë caktimit të periudhës së ofrimit të kësaj praktike, e cila duhet të jetë brenda periudhës së vitit akademik dhe njëkohësisht për numrin e studentëve në bazë të nevojave të Komunës;
- d) Të lëshoj në fund certifikatë në bashkëpunim me palën tjetër, e cila duhet të përmbaj vulën e këtyre dy palëve si dhe nënshkrimet e përfaqësuesve të tyre si dëshmi e përfundimit të punës praktike.

200

L.3

Neni 5

Përgjegjësitë e Këshillit të Studentëve të Fakultetit Juridik

- a) Të përzgjedh studentë nga Fakulteti Juridik, të cilët janë banorë të Komunës së Drenasit për punë praktike në këtë institucion;
- b) Përzgjedhja të bëhet në bazë të krijimit të një Komisioni të përbashkët për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhje;
- c) T'ua dërgoj Komunës së Drenasit listën e studentëve të përzgjedhur për punë praktike;
- d) Në koordinim me Komunën të vendos për periudhën e përfundimit të punës praktike të studentëve të dërguar si dhe të paktën një herë gjatë kësaj periudhe të vizitoj këta studentë dhe të monitoroj punën dhe angazhimin që bëjnë;
- e) Në bashkëpunim me palën tjetër të lëshoj dëshminë e përfundimit me sukses të punës praktike të ofruar.

Neni 6

Ndryshimi i Memorandumit

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin unanimit të të dy palëve dhe kohëzgjatja e tij është në vullnetin e lirë të palëve, sipas vlerësimit të tyre diskrecional.

Neni 7

Hyrja në fuqi e Memorandumit

Memorandumi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy Palët. Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi paraprak nga ana e çdo Pale.

Memorandumi mbahet në dy kopje origjinale për secilën prej palëve dhe në rast konfuziteti në interpretim do të vlejë ai kuptim që jep përfundimin më të favorshëm për palët.

2.20

L.3

Neni 8

Përfaqësimi i Palëve

Secila prej palëve do të përfaqësohet prej udhëheqësve të këtyre subjekteve.

Neni 9

Ky memorandum bashkëpunimi nënshkruhet në datën 14.10.2021 në Drenas, Kosovë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



Këshilli i Studentëve i Fakultetit Juridik

Leotrim Pajaziti

